



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-19-4335-5-3-6/C183
14 Nr. 626/19
Dt. 01.08.2019

KONTRATË PUNE/SHËRBIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Saranda Cakaj – Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**) , dhe
2. **NNP “ Wenda “** me seli në Vushtrri, me NRB: 80281714 e Nr. Fiskal: 600203939, të cilën e përfaqëson **z. Kadri Selmani**, në tekstin e mëtejshëm: **KRYESI I PUNËVE/ SHËRBIMEVE**,

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për ekzekutimin e shërbimeve dhe / ose punëve, si në vijim :

Renovimi objektivit të shtëpisë rezidenciale në fsh. Lum Madh , me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	9	43	3	5	5	3	6
Prokurimi Nr.	644	1	9	0	7	0	5	3	6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë : **Renovimi si dhe ekzekutimi i shërbimeve dhe / ose punëve tjera në objektin e shtëpisë rezidenciale në fsh. Lum Madh si punëve përgaditore, të detyrës dhe dritareve si dhe të verandës dhe kubzimit , në pajtim dhe në sasi si në Specifikimin Teknikë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit. Afati i fillimit të punëve është jo më gjatë se dy ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës, ndërsa ekzekutimi i shërbimeve dhe / ose punëve duhen të përfundohen në afatin, jo më gjatë se 20 ditë pune pas datës së fillimit të ekzekutimit të Shërbimeve dhe / ose Punëve.

1.3 Vendi i rregullimit të objektit – shtëpisë rezidenciale është fsh. Lum Madh.

1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **3.976,39€ (tremijënjëqind e shtatëdhjetë e 39 Euro).**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës **pas pranimit teknik të shërbimeve dhe / ose Punëve të ekzekutuara të konfirmuara nga Komisioni i Pranimit në Raportin e Pranimit.**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti respektivisht cilësia e **punëve dhe / ose shërbimeve** duhet, në të gjitha aspektet, të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni, përmes Deklaratës me shkrim, do të mbetet valid për **36 muaj**, pas pranimit të **punëve dhe / ose shërbimeve**.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **punëve dhe / ose shërbimeve** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërrprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit

kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik:
NNP "Wenda" – Vushtrri

Për Autoritetin Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë

Emri:	Kadri Selmani	Emri:	Saranda Cakaj
Pozita:	Pronar	Pozita:	Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	01.08.2019	Data:	01.08.2019
Vula:		Vula:	

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G
Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%, 8%-apo 18%. Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy decimale pas presëjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSH)-€	Vlera (Pa TVSH)	TVSH	Vlera (me TVSH)-€
Punët Përgaditore									
1	Rrethimi i truallit për ndërtimin e objektit, latesia e rrethojës duhet të jetë ~2.0m, shtyllat nga profile metalike si dhe rrethoja nga llamarinat.	m ²	35.00	7.63	18.00	9.00	266.95	48.05	315.00
Punët e Dritareve dhe Dyerve									
	Furnizimi dhe montimi i dyerve prej materialit të plastikës, me xham termopan dhe të gjitha pjesët tjera përcjellëse dhe me hapje në të dy drejtimet horizontale dhe vertikale. Vërejtje: Masat të mirren në vend!								
2	Pos 210x140+40	copë	1.00	313.56	18.00	370.00	313.56	56.44	370.00
3	Pos 90x210+40	copë	1.00	203.39	18.00	240.00	203.39	36.61	240.00



4	Furnizimi dhe montimi i paneleit të plastikës me xham termopan 4+16+4 dhe të gjitha pjesët tjera perçelëse, si dhe të pajisur me mekanizem këthyes përmbyllës .paneli do të punohet me paneli parped në lartësi h=0,7cm	m ²	13.02	21.19	16.00	25.00	275.85	49.65	325.50
	Furnizimi me material dhe montimi i kullit mbi konstruksionin e para hyrjes nga materiali pcv i kombinuar me xham katër sinorë me trashësi t=6mm								
5	Pos 400x2,10	copë	6.72	33.05	18.00	39.00	222.10	39.98	262.08
Punët e Kubëzimit dhe Verandës									
6	Furnizimi me material dhe betonimi i themeleve të veçuara me dimensione 40x40x80cm MB30 në këtë pozicionë është përfshirë edhe punët e gërmit ,shtrufës së zhavorit me trashësi t=10cm	copë	11.00	21.19	16.00	25.00	233.05	41.95	275.00
7	Furnizimi me material dru i klasit të parë me mensione 12x12x400cm i ankeruarë i cili do të shfitezohet për shtylla vertikale, pahi nënëpahi për konstruksionin e kulmit i cili do të drasohet	m ³	3.71	203.39	18.00	240.00	735.15	135.93	891.07
8	Furnizimi me material dhe drasimi i konstruksionit të kulmit me dyshem druri me qep dhe zbleb me trashësi t=2,4cm nga të dy anët e lënuara.	m ²	29.26	2.97	18.00	3.50	88.79	15.62	102.41




9	Furnizimi me material dhe mbulimi i kullimit me tegolla kanadeze sipas standardeve për këtë lloje kullimi, ngjyra caktohet nga org. mbikqyrës	m ²	29.60	6.78	18.00	8.00	200.68	36.12	236.80
10	Furnizimi me material dhe ankerimi i profileve metalike në betonin	copë	11.00	10.17	18.00	12.00	111.86	20.14	132.00
11	Furnizimi me material dhe lyja me liak pa ngjyrë në dy shtresa e shtyllave, drurit horizontal dhe atë vertikal dhe drasave nënë traj.	m ²	55.00	0.83	18.00	0.98	45.68	8.22	53.90
12	Furnizimi me material dhe fërkimi i drurit (strug me 01) i trajve drurit horizontal dhe atyre vertikal nga te kater sipërfaqet	pauzë hall	1.00	29.66	18.00	35.00	29.66	5.34	35.00
13	Furnizimi me material dhe shtruria e kubzave të betonit me trashësi t=7cm t ë ngjyrosura të montuara mbi shtesat e zhavorit	m ²	56.25	5.51	18.00	6.50	309.85	55.77	365.63
14	Furnizimi me material dhe shtruria me zhavorë 060 me trashësi t=20cm me ngjeshmeri 50MPA	m ²	7.00	5.08	18.00	6.00	35.59	6.41	42.00
15	Furnizimi me material dhe shtruria e zhavorit 031 me trashësi t=10cm me ngjeshmeri 60MPA	m ²	35.00	5.06	18.00	6.00	177.97	32.03	210.00
16	Furnizimi me material dhe motimi i gurve skajorë 8x20x80 l moutarë me te gjitha materialet e nevojshme si beton l gjysem l tenure	m ^l	24.00	4.24	18.00	5.00	101.69	18.31	120.00
TOTALI PËRGJITHSHËM ME TVSH:							3,369.82	606.57	3,976.39

✓



Numri i prokurimit: VU64-19-4335-5-3-6 apo nr. i brendshem: VU64-19-070-536 Titulli: Renovimi i objektit të Shtëpisë Rezidenciale

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	NNP "VENDA"
EMRI DHE MBEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Kadi Selmani
NËNSHKRIMI:	
DATA:	28.06.2019
VULA:	

